



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVË - SHIRËZIMAR OPSTINE MALISHEVË



PRANUAR ME

ACCEPTED ON

PRIMLJENO

14.09.2024

02.391

Nr.No.Br.

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 03.09.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 14 paragrafi 1, neni 17 pika a,b dhe s të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), të nenit 25 par 25.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03 Prill 2019), Rregullores QRK-nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 29 par 29.4 dhe 29.5, dhe nenit 31 par.1 dhe neni 31 par1 pika 5 Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 të datës, 14.09.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 03.09.2024 merr këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik, sipërfaqja prej 33 m², nga pjesa e njësisë kadastrale, nr.P-72310047-01004-22 dhe njësisë kadastrale P-72310047-01004-21, në vendin e quajtur Golesh-Golesh, të dy njësitë në sipërfaqe të përgjithshme prej 900 m² zona kadastrale Malishevë, pjesë e pronës 1/1, në pronësi të, z. [redacted] nga fshati Astrazup, Komuna e Malishevës,

2. Qëllimi i Shpalljes zonë me Interes të Përgjithshëm publik, të pjesës së njësisë kadastrale të cekura sipas nenit 1 të këtij vendimi, është realizimi i interesit publik për një qëllim të ligjshëm publik, ngase në pjesët e njësive kadastrale të shpallura zonë me interes të përgjithshëm publik, gjendet rruga në lagjen Mirëdita në Qytetin e Malishevës, me infrastrukturë përcjellëse rrugore në Qytetin e Malishevës, të cilat janë në shërbim publik, ndërsa sipërfaqja e cila do të merret në këtë rast do t'i bashkëngjitet pronës publike-zgjerimi i rrugës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: skica grafike, kopjet e planit, certifikatat e njësive kadastrale.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

1. MAPL-së,
2. Drejtorive të KK-së
3. Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

